



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 110, Datë 02.07.2020

“MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 86, DATË 12.05.2020 “MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të neneve 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 52, pika 3 dhe nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 16, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Regullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.78/2 prot, datë 26.06.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.05.2020,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 24.03.2020, vendosi: Fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas marrjes së këtij vendimi, të ndodhur dhe në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19, si dhe shpalljes së gjëndjes së Fatkeqësisë Natyrore në Republikën e Shqipërisë, në datën 31.03.2020, Shoqërisë i është dërguar me e-mail (në adresën që rezultonte nga ekstrakti historik i QKB-së i depozituar në ERE së bashku me dosjen e aplikimit) shkresa për njoftimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s sipërcituar si dhe kërkesa për depozitim të dokumentacionit të munguar apo informacionit shtesë.
- Shoqëria nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar brenda afatit të përcaktuar për vendimarrje.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 12.05.2020 vendosi: Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Për këtë vendimarrje shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., është njoftuar me shkresën e ERE-s nr. 447/1 prot, datë 14.05.2020, (dërguar nëpërmjet postës, në adresën e shoqërisë që rezulton në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)).

- ERE ka proceduar në vijim me ridërgimin e shkresës sipërcituar në adresën sekondare të lënë në formatin e aplikimit nga përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447/2 prot, datë 28.05.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE—s nr. 86, datë 12.05.2020, me pretendimin se nuk e ka marrë njoftimin për fillimin e procedurës, për shkak se e-mail-i i vendosur në ekstraktin historik të shoqërisë, i përket një punonjësi të larguar nga shoqëria.
- Bashkëlidhur kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 86, datë 12.05.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka depozituar dhe një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- ERE vlerëson se kërkesa e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore, që kanë të bëjnë me legjitimitimin e palëve dhe afatin për të paraqitur një kërkesë të tillë.
- Gjatë shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë është konstatuar se nuk është plotësuar ende tërësisht dokumentacioni i kërkuar për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 447/3 prot, datë 11.06.2002, duke i kërkuar që të depozitojë dokumentacionin e munguar.
- Me shkresën nr. 447/4 prot, datë 19.06.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka kërkuar zgjatjen e afatit me 10 ditë të tjera për depozitimin e këtij dokumentacioni.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e shqyrtimit të kërkesës së Shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së Shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI